

VENDIM
Nr. 129, datë 6.3.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 99, DATË 27.2.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË
FUNKSIONIMIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 25, 70 e 71, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- I. Në vendimin nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
1. Në titull dhe kudo në përmbajtje të vendimit, emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar” zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar” dhe akronimi “DPAP” zëvendësohet me “AKAP”.
 2. Kudo në përmbajtjen e vendimit, emërtimi “Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë” zëvendësohet me “Ministria e Arsimit dhe Sportit”.
 3. Në kreun III bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Shkronja “a”, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“a) nivel qendror, nëpërmjet agjencisë kombëtare;”.
 - b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“5. AKAP-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e agjencisë kombëtare dhe përgjigjet përpara ministrit. Drejtori i përgjithshëm emërohet dhe lirohet nga ministri. Drejtori i përgjithshëm mbështetet nga 1 (një) zëvendësdrejtor i përgjithshëm, i cili emërohet me të njëjtat procedura si drejtori i përgjithshëm.”.
 - c) Në pikën 6, fjalët “... drejtorisë së përgjithshme në nivel qendror ...” zëvendësohen me “... agjencisë kombëtare ...”.
 - ç) Në pikën 8, fjalët “Drejtoria qendrore ...” zëvendësohen me “Agjencia kombëtare ...”.
 - II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama